



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 6
Prishtinë, më 10 maj 2011, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Valbon Bytyçi- ZAP, Dino Asanaj dhe Shkëlzen Lluka –AKP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës) Albert Krasniqi dhe Arta Demolli – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky
Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 26.04.2011,
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Armend Zemaj – Propozoi që në rend dite të përfshihet edhe shqyrtimi i Projektligjit për raportim financiar, kontabilitet dhe auditim, duke pasur parasysh që i njëjti do të diskutohet në mbledhjen e radhës plenare.

Kryesuesi – Me këtë projektligj është ngarkuar Komisioni për Buxhet dhe Financa, por propozoi që kjo çështje të diskutohet në pikën të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26 prill 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 26 prill 2011.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryesuesi- Tha se për shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës janë ftuar kryesuesi i Bordit të AKP- së dhe drejtori menaxhues. Me kërkesë të tyre mbledhja është shtyrë për në orën 14 dhe të njëjtin nuk i janë përgjigjur ftesës, por kanë dërguar përfaqësues të tjerë. Të gjeturat e ZAP- it janë të mëdha dhe për të shqyrtuar këto gjetje duhet të jenë të pranishëm anëtarët e bordit. E hap diskutimin.

Armend Zemaj – Ishte i mendimit se për shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës duhet të jenë të pranishëm ata të cilët i ka emëruar vetë Kuvendi, pra anëtarët e bordit. Mos prezenca e njërit nga anëtarët e bordit para këtij Komisioni, është një devijim nga përgjegjësia që kanë para Kuvendit, duke pasur parasysh edhe Ligjin për AKP- në. Propozoi që ky raport të mos shqyrtohet pa praninë e anëtarëve të bordit.

Valbona Dibra – Tha se personat e pranishëm nga AKP- ja, janë personat adekuat për shqyrtim të këtij raporti, pasi që janë pikërisht personat që e kanë përcjellë auditimin në këtë institucion. Kjo nuk duhet të jetë arsyeja për shtyrje të shqyrtimit të këtij raporti. Personat e pranishëm mund të japin më shumë informata se sa vetë kryesuesi i bordit.

Armend Zemaj – Tha se pavarësisht që personat e pranishëm mund të japin informata të mjaftueshme për shqyrtimin e këtij raporti, megjithatë të pranishëm duhet të jenë ata të cilët janë emëruar nga Kuvendi. Ne kemi të bëjmë me një agjenci shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik. Përgjegjësia i takon atyre që janë zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës.

Afrim Hoti – Ishte i një mendimi me deputetin Armend Zemaj dhe propozoi që të votohet për këto dy propozime.

Ramiz Lladrovci – Tha se nuk është kundër për të shtyrë këtë takim, por ishte i mendimit që të votohet vetëm për propozimin që të shtyhet shqyrtimi i raportit për një mbledhje tjetër, ku do të jenë të pranishëm përfaqësuesit e bordit të AKP- së.

Kryesuesi – Tha se arsyet për shtyrje janë të mëdha si p.sh., janë katër rekomandime që nuk janë përfillur fare nga bordi i AKP- së.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Shqyrtimi i raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010, shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

4. Të ndryshme

a). Kryesuesi njoftoi anëtarët e Komisionit me Udhëzimin Administrativ për administrimin e buxhetit të Komisionit.

b). Kryesuesi njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP- it për vitin 2010.

c) Projektligji për raportim financiar, kontabilitet dhe auditim

Kryesuesi – Për shqyrtimin e këtij Projektligji është ngarkuar vetëm Komisioni për Buxhet dhe Financa. Propozoi formimin e një grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji. Po ashtu ligji duhet të ketë një pjesë me të cilën do t'i obligojë ndërmarrjet publike që gjatë vitit të angazhojnë kompani për auditimin e buxheteve të tyre.

Valbona Dibra – Propozoi që të formohet një grup punues, i cili do ta shqyrtojë këtë projektligj dhe t'i prezantojmë në lexim të parë, pastaj mund të bëjë amendamente gjatë shqyrtimit.

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm – Kësaj do t'i shtoja edhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Ne kemi propozuar se duhet të amendamentohet edhe ky ligj duke ju referuar asaj se kush është institucioni që duhet të caktojë auditorit për ndërmarrjet publike. Kjo sipas ZAP- it duhet të bëhet nga pronari - në këtë rast Qeveria. Është kundër çdo standardi që zyrtari i prokurimit në këto kompani cakton auditorin për atë kompani. Këtë është dashur ta bëjë Ministria e Ekonomisë, si dhe është e rëndësishme që të përcaktojë se çfarë lloj auditimi duhet të bëhet. Kjo çështje duhet të adresohet nga ky Komision.

Kryesuesi – Ndau mendimin me z. Lage, dhe Komisioni mund të japë kontribut në këtë drejtim.

Muhamet Mustafa – Çështja e auditimit dhe raportimit të kompanive publike në Kuvend, është shumë serioze. Ne marrim raportet për entitete shumë të vogla se sa ndërmarrjet e mëdha që kanë shumë rëndësi në jetën e shoqërisë kosovare. Duhet të shihet Ligji për ndërmarrjet publike, në mënyrë që këto ndërmarrje mos t'i raportojnë vetëm Qeverisë, por t'i raportojnë Kuvendit. Kurse sa i përket qeverisjes së këtyre ndërmarrjeve esenciale është qeverisja korporative. Bordi i përgjigjet pronarit, pjesë e së cilës duhet të jetë edhe auditimi. Qeverisja korporative lidhet me funksionimin e bordeve të ndërmarrjeve publike. Kush i zgjedh këto borde? Ishte i mendimit se është dashur të zgjidhen nga Kuvendi. Ligji aktual duhet të shikohet në mënyrë kritike. Bordet e përfaqësojnë interesin partiak, pra jo vijën e interesit publik. Lidhur me këtë duhet të iniciohet debat në Kuvend.

Kryesuesi – Tha se Komisioni duhet të përpiqet që kjo të vihet në kornizë ligjore. Anëtarët e Komisionit mund të japin kontribut rreth këtij ligji.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nxori këtë

Përfundim

Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për raportim financiar, kontabilitet dhe auditim në këtë përbërje: Valbona Dibra –kryesuese,

Armend Zemaj – anëtar dhe

Albert Kinolli – anëtar

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu